



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0151

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE) “ALBOSS” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KK PRIZREN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me numër të prokurimit 622-23-14027-5-2-1, me 30/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “ALBOSS” SH.P.K. me nr. 2024/0151 , e datës 22/02/2024, kurse vendimi i AK “KK PRIZREN” lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizrenit me numër të prokurimit 622-23-14027-5-2-1.

2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK PRIZREN”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 15.12.2023, “KK PRIZREN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1. Ndërsa me datën 07.02.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Ridvan Elezi B.I”.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: 342,000.00 €.

Me 10.02.2024, OE “ALBOSS” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 15.02.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të bazuar.

Me 22.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ALBOSS” SH.P.K., me nr. 2024/0151 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALBOSS” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi nr.1 : “OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 2 piken B të kapacitetit teknik dhe profesional, ku AK-ja ka kërkuar: një inxhinier të diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion. Këtë arsyetim OE ankues e bazon në diplomën e inxhinierit të hidros (Rijad Zejnelit) të OE të rekomanduar për kontrate, në të cilën është e shënuar data e diplomimit: 05.02.2020 dhe sipas OE ankues nuk e plotëson kërkesën e DT-se, për 5 vite përvojë pune.”

Pretendimi nr.2 : “OE ankues, në ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontrate, nuk e ka plotësuar kërkesën nr.2 pikë F: Dy saldues të certifikuar si saldues profesional të pajisur me certifikata të kësaj lëmie. Konkretisht pretendon se dy certifikatat janë të lëshuara nga një institucion i quajtur NTSH WELD-KOS, për të cilin nuk kemi asnjë informata që është i akredituar dhe adekuat për lëshimin e certifikatave për Saldim, njëherit e konteston validitetin e certifikatave të cilat e kanë të njëjtë dhe të lëshuara 5 ditë para hapjes dhe kërkon verifikimin e dy certifikatave.”

Pretendimi nr.3: “OE ankues, në ankesën ka një pretendim lidhur me pajisjet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate, për të cilin pretendon se nuk e plotëson kërkesën nr. 4 pikë A) Dy kamion kiper me peshe bartëse mbi 10ton. Sipas OE ankues, OE i propozuar për kontrate ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me BM GROUP SHPK për kamione kiper mbi 10ton pesha bartëse, mirëpo kamioni me targa 01-284- MI, shihet qartë në librezë që ky kamion është në pronësi të kompanisë MINERAL LLC.”

Pretendimi nr.4: “Ngjashëm sikurse të pretendimi nr. 3, OE ankues pretendon se edhe për pajisje tjera të OE të rekomanduar për kontrate, se i njëjti për pajisjen eskavator 4.5 deri 6 ton dhe për këtë eskavator nuk e ka paraqitur DUD-in doganor por vetëm një faturë nga kompania Bora BB në emër të BM GROUP shpk, në të cilën nuk specifikohet pesha e bagerit në fjalë, poashtu pretendon se për 1 ngarkues për realizimin e projektit OE i rekomanduar për kontrate e ka paraqitur një faturë e cila është lëshuar nga kompania N.P.SH MALOKU në emër të kompanisë TECH GROUP SHPK. Pra në këtë rast kompania BM GROUP nuk figuron askund dhe nuk kemi asnjë marrëveshje të prezantuar me kompaninë TECH GROUP, gjithashtu OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate për pajisjen: 2 eskavator nga 14 deri 20ton, nuk ka paraqitur DUD doganor të kësaj makinerie në mënyrë që të vërtetohen të dhënat për pajisjen.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ALBOSS” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 69 të LPP-së. Duke propozuar që të Aprovohet si e bazuar ankesa e kompanisë ALBOSS - Anullohet Njoftimi për Vendimin e AK i

datës 07.02.2024 - Rivlerësohet aktiviteti i prokurimit dhe rekomandohet për kontratë kompania ALBOSS si tenderues i përgjegjshëm dhe me ofertën me te lire ne përputhje me kriteret e dhënies se kontratës.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues, me datën 15.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pabazuar për arsyet në vijim:

1. Edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, Autoriteti kontraktues konstaton se nuk qëndron pretendimi juaj lidhur me përvojën e punës të Injinerit të cilin OE I propozuar për kontratë e ka prezantua si staf të rregullt, Sepse në kërkesën tonë në DT dhe NJK citojmë: Një injinjer i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion. i certifikuar për sigurimin dhe kontrollollin e cilësisë sipas ISO 9001 2015 si dhe të jetë i certifikuar si ekspert për siguri dhe shëndet në punë.

Ky kriter përmbushet në tërësi nga stafi I propozuar prej OE.

2. Pretendimi lidhur me muratoorin gjithashtu është I paqëndrueshëm sepse edhe këtë kriter OE I propozuar për kontratë e plotëson në tërësi.
3. Lidhur me pretendimin e pajisjes teknike të kontestuar iu bëjmë me dije se OE ka ngritë dy libreza për këtë pajisje, njëra e skaduar dhe librezën e dytë e vcila është e rregullt. Të dhënat e ofruara nga këto dy libreza të cilat kanë të bëjnë për të njëjtën pajisje e kompletojnë në tërësi kërkesën e AK lidhur me këtë pajisje.
4. Edhe pretendimet tuaja në vazhdim konsiderohen të paqëndrueshme lidhur me këtë OE.
5. OE I propozuar për kontratë ka çmimin ofertues dukshëm më të ulët se çmimi juaj andaj edhe ky fakt e bën të përgjegjshëm këtë OE kurse juve iu bën të pasuksesshëm.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 00151/24, ndërsa me datë 11.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0151 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në

sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ALBOSS” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0151 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr.1: “ Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, sqaron se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se inxhinieri i përmendur më lartë ka diplomuar me datën: 05.02.2020 dhe rrjedhimisht nuk e arrin përvojën e kërkuar nga AK-ja, për 5 vite përvojë punë.

Përgjigje në pretendimin nr.2: “Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim fillimisht sqaron se dëshmitë janë sipas kërkesës, mirëpo në përgjigje të kërkesës së OE ankues për verifikim, eksperti shqyrtues pasi i ka analizuar certifikatat e lëshuara nga NTSH WELD-KOS, nuk ka gjetur ndonjë email apo nr. kontaktues për të verifikuar, pra dëshmitë në fjalë nuk përmbajnë asnjë të dhënë përveç emrit NTSH WELD-KOS – Prishtinë. Lidhur me këtë çështje eksperti

shqyrtues, ka kërkuar përmes emrit, ne web faqe te ARBK-se, mirëpo nuk rezulton asnjë e dhënë për biznesin NTSW WELD-KOS B.I. – Prishtinë. Eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, gjate rivlerësimit duhet të beje verifikimin e dëshmimeve ne fjalë konform nenit 72 dhe 59 të LPP-së. Poashtu lidhur me këtë çështje OE ankues pretendon se, nëse i referohemi kontratës se punës qe OE i rekomanduar për kontrate ka me njërin nga te certifikuarit për saldim, z. Kafer Gerdellaj, të njëjtit me kontratë i është caktuar detyra e muratorit dhe jo e salduesit. Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron për faktin se pavarësisht njërit drejtim qe ka, i njëjti mund te certifikohet edhe ne drejtime tjera.” Nga pretendimi i cituar me larte, eksperti shqyrtues siç e ka sqaruar edhe me larte, është nevojshme te behet verifikimi i dy dëshmime-certifikatave te saldimit.”

Përgjigje ne pretendimin nr.3: “Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit te dëshmisë ne fjalë, konkretisht librezës me nr. 01-284-MI, vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues dhe njëherit sqaroj se i njëjti nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi (fature) se pajisja është blere nga Mineral LLC. Këtë pretendim AK-ja gjate rivlerësimit duhet të verifikojë.”

Përgjigje ne pretendimin nr.4: “Lidhur me pretendimet e OE ankues për pajisjet e përmendura me lart, eksperti shqyrtues sqaron se qëndron ky pretendim i OE ankues sepse dëshmitë janë kontradiktore dhe nuk janë ne përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktues sepse ne dosje te tenderit si dëshmi janë kërkuar qe pronësia te dëshmohet me DUD, kontrata shitblerje ose dëshmi për marrjen në shfrytëzim të pajisjeve, të cilat OE ankues nuk i ka ofruar sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe njëherit për këtë pretendim të OE ankues fillimisht është i nevojshëm verifikimi i dëshmimeve të OE të rekomanduar për kontratë.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALBOSS” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALBOSS” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALBOSS” SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALBOSS” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Ndërtimi i strehimores për qent endacak në Komunën e Prizreni” me nr. të prokurimit: 622-23-14027-5-2-1 të rivlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Autoritetet kontraktuese janë të obliguara që vlerësimin, egzaminimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjnë konform nenit 59 të LPP, AK ka mundësi të aplikoj nenin 72 i cili shprehimisht përcakton qartë nëse një dokument ka ekzistuar para ofertimit të tij/saj në këtë tender, që janë të pranueshme me këtë dispozitë, e në këtë rast janë vetëm dokumente zyrtare dhe publike por edhe dokumente tjera që nënkupton marrëveshje paraprake të nënshkruar tek noteri për marrje në shfrytëzim ose blerje të pajisjeve ose me dud doganor. Po ashtu, AK sa i përket çertifikateve të saldimit mund ta kryej një kontroll efektiv konform nenit 52.7 të LPP, si dhe secila palë në procedurë në këtë rast ankuesi, dyshimet rreth falsifikimeve duhet me ju drejtuar organeve kompetente, sepse OSHP nuk ka kapacitete teknike dhe as profesionale për të bërë verifikimin e tyre.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - "ALBOSS"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: